

## **AKT – THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **“TOTO IMPORT” sh.p.k.**

Sot ne daten **21.02.2022**, un ortaku themelues :

**Z. Antonio Aliberti** , shtetas italian , i datelindjes **29/10/1973** , atesia **Mario** , lindur ne **Pomigliano D’Arco ( NA)** , banues ne **Lagjja nr 13** , rruga **Pavaresia shk 1, kati 4** , **AP 63 Durres** , **Shqiperi** , i pajisur me karte identiteti italiane me nr **AY8505287** , leshuar me date **11.08.2020** ,madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” , kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “**Toto Import**” sh.p.k.

#### **NENI 1 EMERTIMI ISHOQERISE**

Shoqeria do te quhet “**Toto Import**” sh.p.k. dhe eshte person juridik shqiptar

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901, date 14.04.2008, si edhe te ligjit per QKR-en.

#### **NENI 2 SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete seline e saj ne **Lagjja nr.1, Rruga Taulantia** , nr pasurie **26/110+1-1/1 zk 8512, Durres.**

Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **NENI 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria do te kryej aktivitetet si me poshte :

**Tregeti me shumice dhe pakice , import eksport te mallrave ushqimore shperndarje ne supermarkete, per vete dhe te trete.**

#### **NENI 4 KAPITALI I SHOQERISE**

**Kapitali i shoqerise “Toto Import” sh.p.k. eshte 1.000 (njemije) leke**

**Ky kapital perbehet nga 1-nje kuotedhe zoterohet nga :**

**Z. Antonio Aliberti qe zoteron 100 % te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren 1.000 leke .**

**NENI 5**  
**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

**NENI 6**  
**ORGANET E SHOQERISE**

-Asambleja e pergjithshme

-Administratoret

**ASAMBLEJA E PERGJTHSHME**

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

-Ndryshimin e Statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve

-Emerimin dhe shkarkimin e likujduesave dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

-Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likujduesin dhe ekspertin kontabel.

-Mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga aministratoret,perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

-Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

-Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.

-Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

-Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

-Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti

**ADMINISTRATORET**

**Administratore e shoqerise do te jete Znj. Migena Hajdarmataj , shtetase shqiptare , e datelindjes 25.01.1981 , atesia Adem , lindur ne Shijak , banuese ne rruga Fransua Pukvil nd 28, H 1 , Njesia AD, e pajisur me karte identiteti shqiptare me nr I15125061N , leshuar me date 26.09.2017,ecilaemerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte ripertesitje.**

Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment nga asambleja,me shumice te thjeshte te votave,me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortakët me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.



**NENI 7**  
**SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE**

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruarne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Po ashtu , Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera,te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

**NENI 8**  
**PRISHJA E SHOQERISE**

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset :

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
- b)me vendim te asamblese se pergjithshme
- c)me hapjen e procedurave te falimentimit
- c)ne se nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perpurhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 per" QKR"
- d) me vendim te gjykates
- dh)per arsye te tjera te parashikuara ne statut

**NENI 9**  
**LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Ne rast te likujdimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likujdator,i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likujdimit.

Me vendim e posacem te Asamblese se Pergjithshme,te marre me shumice te kualifikuar,pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likujdatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve.Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likujduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj.Shoqeria e publikon dy here kete njoftim,me nje interval prej 30 ditesh,ne faqen e saj te internetit,si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

**NENI 10**  
**PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT**



Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura,likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likujdimit dhe kerkon crregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likujduesit nuk mund te kundershohet pas crregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

**NENI 11  
MOSMARREVESHJET**

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast tekundert, ortaket themelues do ti drejtohen Gjykates kompetente per zgjidhje.

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

**“TOTO IMPORT” sh.p.k.**

**Antonio Aliberti**

ANTONIO ALIBERTI

Antonio Aliberti